



MARS 2015

EKONOMIA DHE BUXHETI

Raport Mujor

Prill 2015

Maj 2015

Qershor 2015

Korrik 2015

Gusht 2015

Shtator 2015

Nëntor 2015

Dhjetor 2015

# EKONOMIA DHE BUXHETI

## Raport Mujor

- Mars 2015 -

© Ministria e Financave, 2015

Drejtoria e Makroekonomisë

Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë

[www.financa.gov.al](http://www.financa.gov.al)

E-mail: [marsed.harizi@financa.gov.al](mailto:marsed.harizi@financa.gov.al)

[eva.doda@financa.gov.al](mailto:eva.doda@financa.gov.al)

# Përmbajtja

<b>VEÇORITË KRYESORE</b>	<b>2</b>
<b>ZHVILLIMET EKONOMIKE</b>	<b>3</b>
1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit	3
2. Kursi Mesatar i Këmbimit	4
3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave	5
4. Bilanci i Pagesave	6
5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar	7
6. Kredia për Ekonominë	8
7. Oferta e Parasë	9
8. Depozitat sipas Burimeve	10
<b>SEKTORI FISKAL</b>	<b>11</b>
1. Buxheti i Konsoliduar	11
2. Të Ardhurat sipas Burimeve	12
<b>ANEKSI STATISTIKOR</b>	<b>13</b>

# Veçoritë Kryesore


- *Indeksi i çmimeve të konsumit* në muajin mars 2015 arriti në 121.9 për qind;
- *Norma vjetore e inflacionit* për muajin mars 2015 ishte 2.2 për qind;
- *Kursi mesatar i këmbimit të monedhës vendase me dy monedhat kryesore të huaja* për muajin mars 2015 ishte 129.66 lekë për dollarë dhe 140.41 lekë për euro;
- *Normat e interesit të depozitave në Lekë* gjatë muajit mars 2015 shënuan kuotat 1.46 për ato 12 - mujore, 1.08 për 6 - mujoret ,0.72 për qind për depozitat 3 - mujore dhe 1.42 për depozitat 1 - mujore;
- *Normat e interesit për huatë në Lekë* ishin 8.74 për qind për huatë 12 - mujore dhe 9.30 për ato 6 - mujore;
- *Oferta totale e parasë*, e matur nga agregati M3, arriti në 1,190.7 miliardë lekë në muajin mars, duke shënuar një rritje prej rreth 4.1 për qind, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë;
- *Bilanci i pagesave* për tremujorin e parë të 2015 rezultoi me një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 55.9 milionë euro;
- *Situata Buxhetore* për muajin janar-mars 2015 rezultoi me një deficit të përgjithshëm prej rreth 4.3 miliardë lekë, që do të thotë se rreth 64% më pak se planifikimi progresiv mujor (ndërkohë që deficitin ishte planifikuar 11.9 miliardë lekë).
- *Të ardhurat* gjithsej të realizuara gjatë periudhës janar-mars 2015, arritën në rreth 86.8 miliardë lekë ose afërsisht 97.3 për qind e planit për muajin.
- *Shpenzimet* gjithsej gjatë të njëjtës periudhë, arritën në rreth 91.1 miliardë lekë ose 90.1 për qind e shpenzimeve të planifikuara për këtë periudhë.

# Zhvillimet Ekonomike

## 1. Indeksi i Çmimeve të Konsumit

Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për muajin Mars 2015 pësoi rritje prej 0.4 për qind krahasuar me muajin Shkurt 2015, kur ky indeks shënonte rritje prej 2.4 për qind, krahasuar me muajin paraardhës. Ndërsa gjatë muajit Janar 2015, ky indeks ishte 1.4 për qind më i lartë se në muajin Dhjetor 2014. Ndryshimet respektive me të njëjtët muaj të një viti më parë ishin rritje me 2.2 për qind, rritje me 2.3 për qind dhe rritje me 1.3 për qind.

Nga tërësia e mallrave dhe shërbimeve që përbëjnë shportën e konsumit, kategoria me kontribut më të lartë në inflacionin e përgjithshëm në muajin mars ishte “Ushqime dhe pije jo alkoolike” me një rritje vjetore të çmimit prej +4.7%, duke kontribuar me +1.9 pikë përqindje. Rënia më e madhe gjatë muajit Mars u konstatua në kategorinë “Shëndeti” me 4.4 për qind. Pësha specifike relativisht e ulët që zë ky grup në shportën e mallrave të konsumit, bën që ndryshimet e çmimeve për këtë grup të kenë efekte të ulëta mbi normën e inflacionit me rreth 0.2 pikë përqindje.



Norma vjetore e inflacionit në muajin Mars arriti në 2.2 për qind. Ndryshimet vjetore të indeksit të çmimeve të konsumit, në përqindje, për vitin 2014 dhe Janar 2015 paraqiten në tabelën 1.

**Tab - 1** Ndryshimi vjetor i Indeksit të Çmimeve të Konsumit (në %)


VITI	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor
<b>2014</b>	1.7	1.9	2.2	1.7	1.6	1.5
<b>2015</b>	1.3	2.3	<b>2.2</b>			
VITI	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
<b>2014</b>	1.8	2.0	1.5	1.4	1.7	0.7
<b>2015</b>						

Burimi: INSTAT

## 2. Kursi mesatar i këmbimit

Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt euros në muajin mars 2015, arriti në 140.41 lekë/euro, duke shënuar rritje me 0.13 për qind krahasuar me një muaj më parë. Në fund të muajit Mars, një euro u këmbye me 140.34 lekë. Kursi mesatar i këmbimit të lekut kundrejt dollarit amerikan në muajin Mars 2015, arriti në 129.66 lekë/dollarë duke shënuar rritje me 5.03 për qind kundrejt muajit Shkurt 2015. Në fund të muajit mars, kursi i këmbimit për dollarin amerikan arriti në nivelin 130.63 lekë/dollarë.

Fig-2



Ecuria e Kursit të Këmbimit gjatë muajit mars 2015

Burimi: Banka e Shqipërisë


Në krahasim me muajin Mars të vitit të kaluar, rezulton se monedha shqiptare është nënçmuar (mesatarisht) ndaj dollarit amerikan në masën 27.7 për qind, ndërsa kundrejt monedhës europiane euro në masën 0.08 për qind. Nënçmimi i lekut, kundrejt dy monedhave kryesore, monedhës europiane dhe monedhës amerikane, është i lidhur me ecurinë e tyre në tregjet monetare ndërkombëtare, duke reflektuar sjelljen e tyre në tregun e brendshëm monetar. Kursi i këmbimit të euros me dollarin amerikan pësoi një rritje mesatare duke arritur në rreth 0.923 dollarë/euro.

Ndër faktorët e brendshëm që kanë ndikuar në ecurinë e monedhës vendase gjatë këtij muaji, përmendim: ruajtja e ritmeve pozitive të rritjes ekonomike në vend, efikasiteti i politikës fiskale, efikasitetet në politikën monetare dhe në operacionet ndërbankare të ndërmarra nga Banka e Shqipërisë, etj.

### 3. Ecuria e Normave të Interesit të Depozitave dhe Huave

Gjatë muajit Mars 2015, normat e interesit të depozitave 12-mujore në lekë arritën kuotën e 1.46 për qind, duke shënuar rënie me 0.11 pikë përqindje krahasuar me muajin Shkurt 2014. Rënie për këtë muaj kanë pësuar gjithashtu normat e interesit të depozitave me afate të maturimit 6 edhe 3-mujore respektivisht me 0.17 dhe 0.18 pikë përqindje, duke shkuar në 1.08 dhe 0.72 për qind. Norma e interesit e depozitave me afat të maturimit një muaj pësoi rënie me 0.09 pikë përqindje, duke shkuar në nivelin 1.42 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, rënie kanë pësuar normat e interesit të depozitave për të gjitha afatet e maturimit 12, 6 dhe 3-mujore.

Fig-3




**Normat e interesit për depozitat (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Interesi i huave 12-mujore gjatë muajit Mars pësoi rritje me 1.38 pikë përqindje, duke arritur në nivelin 8.74 për qind nga 7.36 për qind që ishte në muajin Shkurt 2015. Gjithashtu norma e interesit të huave 6-mujore për këtë muaj shënoi rritje me 1.13 pikë përqindje krahasuar me një muaj më parë. Interesi i huave 6-mujore për muajin Mars arriti në 9.30 për qind. Krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, normat e interesit të huave me afate maturimi 12-mujor kanë pësuar rritje ndërsa ato me afat maturimi 6-mujor kanë shënuar rënie.

Fig-4




**Normat e interesit për huatë dhe bonot (%)**

Burimi: Banka e Shqipërisë


Normat e interesit të bonove të thesarit gjatë muajit Mars 2015, për bonot 12, 6 dhe 3-mujore ishin përkatësisht 3.59, 3.25 dhe 3.11 për qind. Gjatë këtij muaji, vihet re rritje në *yield*-in e bonove të thesarit për afatet e maturimit 12 dhe 6-mujore përkatësisht me 0.01 dhe 0.02 pikë përqindje dhe rënie me 0.08 pikë përqindje për ato 3-mujore.

## 4. Bilanci i Pagesave

Bilanci i pagesave për tremujorin e parë të 2015 regjistroi një tepricë të bilancit të përgjithshëm prej 55.9 milionë euro, karakteristika strukturore e të cilit paraqitet në figurën 5. Kontributin më të madh në të e jep zëri “Llogaria korrente” së bashku me nënzërat e saj, me -230.2 milionë euro, duke u ulur në vlerë absolute me 15.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. “Llogaria kapitale dhe financiare” për tremujorin e parë të 2015 rezultoi të jetë me një deficit prej 208.9 milionë euro ose gati 49% më e lartë se në tremujorin e parë të 2014.




Kompozicioni i llogarisë korrente prej -230.2 milionë euro, është shprehur sipas elementeve kryesorë përbërës (në terma neto) për vitin 2014: (i) bilanci tregtar -468.7 mln euro, (ii) shërbime neto 103.1 mln euro, (iii) të ardhura neto -49.4 mln euro, (iv) transferta neto 184.9 mln euro. Kjo strukturë në mënyrë vizuale paraqitet në figurën 6.




## 5. Mjetet Valutore Neto të Sistemit Bankar

Gjatë muajit Mars 2015, sistemi bankar ka shënuar rritje të mjeteve valutore neto (M.V.N), me rreth 75.7 miliardë lekë krahasuar me muajin Mars të vitit 2014. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 44.6 miliardë lekë dhe të rritjes së mjeteve valutore neto të bankave të nivelit të dytë me rreth 31.0 miliardë lekë.




Në muajin Mars 2015 sistemi bankar rezulton me një rritje prej 15.6 miliardë lekë në mjetet valutore neto, krahasuar me muajin shkurt 2015. Kjo rritje ka ardhur si pasojë e rritjes së mjeteve valutore neto të Bankës së Shqipërisë me rreth 3.4 miliardë lekë dhe të bankave të nivelit të dytë me rreth 12.1 miliardë lekë.



## 6. Kredia për Ekonominë


Totali i kredisë për ekonominë për muajin Mars 2015 arriti në 557,402.4 miliardë lekë. Rritja e tepricës së kredisë, krahasuar me mars 2014 shënoi rritje me vlerë 12,575 miliardë lekë, pra rritje prej rreth 2.3 për qind. Struktura e tepricës së kredisë sipas monedhave mbizotërohet nga kredia në valutë, duke përbërë rreth 57.7 për qind të totalit të tepricës së kredisë me rreth 321,772.5 milionë lekë. Gjatë muajit mars 2015, zëri “Korporata jofinanciare private”, zuri peshën më të lartë të kredive, me rreth 65.6 për qind ose 365,598 milionë, ndjekur nga kreditë për individë, ku pesha e tyre specifike arriti në nivelin 28 për qind ose 154,802 milionë lekë. Zërat “Korporata jofinanciare publike” dhe “Korporata të tjera financiare” arritën respektivisht 5.0 dhe 1.0 për qind apo 28,189 dhe 7,951 milionë lekë.

Për sa i përket shpërndarjes së kredisë sipas monedhës për muajin mars 2015, zëri “Korporata private jofinanciare” zuri peshën më të lartë të kredive në lekë, me rreth 54.36 për qind, ndjekur nga “Sektorë të tjerë rezidentë” me rreth 33.8 për qind dhe nga “Korporata publike jofinanciare”, me 10.7 për qind. “Korporata private jofinanciare” dhe “Sektorë të tjerë rezidentë” zënë gjithashtu pjesën më të rëndësishme të kredive në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 73.81 për qind dhe rreth 23.3 për qind.



**Rritja e stokut total të kredive**

Burimi: Banka e Shqipërisë




**Përberja e kredive Mars '15**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 7. Oferta e Parasë

Oferta e parasë (e matur me M3), për muajin Mars 2015 shënoi rënie prej 0.1 për qind krahasuar me muajin paraardhës Janar 2015. Kjo ofertë arriti në rreth 1,190,772.3 milionë lekë në fund të muajit mars 2015 duke shënuar një rënie prej 1,402.4 milionë lekë kundrejt nivelit të regjistruar në muajin shkurt 2015. Rritja vjetore e këtij treguesi ishte 4.1 për qind.

Fig-11




**Raportet e parasë jashtë bankave me M3 dhe Depozitat**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Depozitat në lekë, si përbërësi kryesor i ofertës monetare, kanë pësuar rënie prej 8.5 miliardë lekë në krahasim me muajin mars 2014. Depozitat në valutë gjatë muajit mars 2015 janë mbështetur kryesisht nga depozitat për individë, të cilat kanë përbërë rreth 85.8 për qind të depozitave në valutë. Ndërsa tek depozitat në lekë sektori i individëve ka zënë rreth 87.6 për qind të tyre.

Fig-12




**Raporti i Depozitave ndaj M3**

Burimi: Banka e Shqipërisë

## 8. Depozitat sipas Burimeve

Gjatë muajit mars 2015, zëri “Sektorë të tjerë rezidentë” zuri nivelin më të lartë të depozitave të transferueshme në lekë, me rreth 87.6 për qind, ndjekur nga “Korporata të tjera jofinanciare”, me rreth 9.8 për qind dhe nga “Korporata jofinanciare publike”, me 1.6 për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” dhe “Korporata të tjera jofinanciare” ishin gjithashtu burimi më i rëndësishëm i depozitave në monedhë të huaj, përkatësisht me rreth 85.8% për qind dhe rreth 11.6% për qind. “Sektorë të tjerë rezidentë” ishin dukshëm burimi më i rëndësishëm i depozitave totale me rreth 86.7 për qind e totalit (në lekë).

Fig-13




**Rritja e stokut total të depozitave**

Burimi: Banka e Shqipërisë

Në përgjithësi, “Sektorë të tjerë rezidentë” përbëjnë pjesën më të madhe (rreth 844.6 mld) të depozitave totale. Ata ndiqen nga “Korporata të tjera jofinanciare” (104.1 mld), “Korporata jofinanciare publike” (15.6 mld) dhe “Korporata të tjera financiare” (8.3 miliardë). “Qeveria lokale” kontribuoi me rreth 1.5 mld në totalin e depozitave. Gjatë muajit mars 2015, krahasuar me një muaj më parë, niveli i përgjithshëm i depozitave shënoi një rritje prej 527 milionë lekë, kjo si rezultat i rritjes së depozitave në valutë me rreth 631 milionë lekë, ndërkohë që depozitat në lekë u ulën me rreth 105 milionë lekë.

Fig-14



**Përberja e depozitave Mars 2015**

Burimi: Banka e Shqipërisë

# Sektori Fiskal


## 1. Buxheti i Konsoliduar

Për periudhën janar-mars 2015 janë mbledhur rreth 86.8 miliardë lekë të ardhura, përkundrejt shpenzimeve të përgjithshme prej 91.1 miliardë lekë, ku pjesa më e madhe përfshin 74.9 miliardë lekë në shpenzime korrente dhe 8.8 miliardë lekë në shpenzime kapitale, nga të cilat 48% janë financim i jashtëm.

Mbledhja e të ardhurave përbën rreth 97% të të ardhurave buxhetore për planin e periudhës, ndërsa shpenzimet përbëjnë rreth 90% të këtij plani. Shpenzimet korrente janë rreth 94% e planifikimit të periudhës të këtij zëri, ndërsa shpenzimet kapitale janë rreth 87% të tij.

Nga të ardhurat gjithsej, pjesa e të ardhurave të mbledhura nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Doganave është rreth 56.7 miliardë lekë (ose rreth 91% e planit të periudhës). Të ardhurat e mbledhura nga pushteti vendor rreth 2.2 miliardë lekë (ose rreth 55% e planit të periudhës). Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore 17.3 miliardë lekë (ose rreth 105% e planit të periudhës) dhe të ardhurat jo-tatimore në nivelin 9 miliardë lekë (ose rreth 170% e planit të periudhës).

Nga totali i shpenzimeve korrente prej 91.1 miliardë lekë, 17.3 miliardë lekë (23% e totalit të shpenzimeve korrente) është shpenzuar për personelin, rreth 8.9 miliardë lekë (12%) për interesat, 6.4 miliardë lekë (8.6%) për shpenzime



operative dhe mirëmbajtje, 301 milionë lekë (0.4%) për subvencione, 31.6 miliardë lekë (42%) për shpenzimet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore dhe 5.7 miliardë lekë (7.6%) për shpenzimet e qeverisjes vendore, 4.6 miliardë lekë (6%) për shpenzimet e tjera. Këto përfaqësojnë 23% (shpenzime personeli), 18% (shpenzime për interesat), 16% (shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes), 17% (subvencione), 22% (sigurimet shoqërore dhe shëndetësore), 14% dhe 19% (për shpenzimet e qeverisjes vendore dhe shpenzimet e tjera) përkundrejt planifikimit të tyre vjetor.

Shpenzimet kapitale me financim të brendshëm për këtë periudhë ishte 15%, ndërsa financimi i huaj është 11% e planifikimit të tyre vjetor.

## 2. Të ardhurat sipas burimeve

Të ardhurat gjithsej të realizuara për periudhën janar-mars 2015 ishin rreth 86.8 miliardë lekë, nga të cilat të ardhurat tatimore rreth 76.1 miliardë lekë, të ardhurat jo-tatimore në rreth 9 miliardë lekë.

Tab - 2

Të ardhurat gjatë periudhës janar-mars 2015 (mld Lekë)

Burimi	mar'15	mar'14	Ndryshimi në (%)
TVSH	27	30.2	-10.6
Tatimi mbi fitimin	8.9	6.3	41.3
Taksa doganore	1.3	1.2	8.3
Taksat nacionale	6.2	7.5	-17.3
Akczat	7.1	6.1	16.4
Tatim mbi të ardhurat personale (TAP)	6.1	6.4	-4.7

Burimi: Ministria e Financave, Statistikat Fiskale: mars – 2015;

Source: Ministry of Finance, Fiscal Statistics: march – 2015;

## 3. Financimi i Bilancit Fiskal

Deficiti prej 4.3 miliardë lekë, për periudhën janar-mars 2015, u mbështet nga huamarrja e brendshme si mjeti kryesor i financimit të brendshëm (rreth 213% të totalit të deficitit), ndërsa për financimin e huaj ishte huaja afatgjatë mjeti kryesor (rreth 66% të totalit të deficitit).

Për muajin mars 2015, disa nga treguesit kryesorë fiskalë ishin:

- Realizimi i të ardhurave në masën 35,325 miliardë lekë,

- Realizimi i shpenzimeve në masën 33,867 miliardë lekë.

Në realizimin e të ardhurave për muajin mars 2015, kontributin kryesor e kanë dhënë të ardhurat e mbledhura nga tatimet, të cilat kapin shifrën e 29.6 miliardë lekë. Në realizimin e shpenzimeve për këtë periudhë, peshën me të lartë e zënë shpenzimet korrente me 28.5 miliardë lekë dhe shpenzimet kapitale me rreth 5.3 miliardë lekë.

# Aneksi Statistikor

Tab - 1		Indeksi i Çmimeve të Konsumit																		
		Consumer Price Index																		
Muaji	Mujor (Monthly)						Mesatar Mujor (Monthly Average)						Vjetor (Annual)						Month	
	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2010	2011	2012	2013	2014	2015		
Janar	0.9	0.8	0.7	1.0	0.8	1.4	1.00	0.80	0.71	1.00	0.80	1.4	3.6	3.3	1.6	2.7	1.7	1.3	January	
Shkurt	1.1	2.3	1.3	1.1	1.4	2.4	1.02	1.55	1.01	1.05	1.10	1.9	4.7	4.5	0.6	2.5	1.9	2.3	February	
<b>Mars</b>	0.1	-0.1	0.4	0.2	0.5	<b>0.4</b>	0.71	1.00	0.80	0.77	0.90	<b>1.4</b>	4.1	4.3	1.0	2.4	2.2	<b>2.2</b>	<b>March</b>	
Prill	-0.4	-0.6	-0.1	-0.1	-0.6		0.42	0.60	0.58	0.55	0.53		3.7	4.1	1.6	2.3	1.7		April	
Maj	-1.2	-1.1	-0.8	-1.0	-1.1		0.10	0.26	0.32	0.24	0.20		3.3	4.2	1.9	2.1	1.6		May	
Qershor	-0.7	-1.1	-0.8	-0.6	-0.7		-0.04	0.04	0.12	0.15	0.05		3.2	3.9	2.2	2.3	1.5		June	
Korrik	-0.5	-0.7	-0.2	-0.8	-0.6		-0.10	-0.07	0.08	-0.03	-0.04		3.4	3.6	2.7	1.6	1.8		July	
Gusht	0.8	0.3	0.4	-0.1	0.1		0.01	-0.02	0.12	-0.04	-0.03		3.5	3.1	2.8	1.2	2.0		August	
Shtator	0.7	0.4	0.2	0.8	0.3		0.09	0.02	0.13	0.06	0.01		3.4	2.8	2.6	1.7	1.5		September	
Tetor	0.2	0.4	0.2	0.1	0.1		0.10	0.06	0.14	0.05	0.02		3.0	3.0	2.4	1.7	1.4		October	
Nëntor	0.2	0.1	0.2	-0.5	-0.2		0.11	0.06	0.14	0.01	0.00		2.8	2.9	2.5	1.0	1.7		November	
Dhjetor	2.2	1.0	0.9	1.7	0.7		0.28	0.14	0.20	0.15	0.06		3.4	1.7	2.4	1.9	0.7		December	

Burimi: INSTAT, Banka e Shqipërisë

Source : INSTAT, Bank of Albania

Tab - 2

## Kursi i këmbimit

Exchange rat Lekë për njësi të monedhës së huaj (Lek per unit of foreign currency)

Monedha	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Currency
						Jan	Feb	Mar	
<i>Mesatarja e periudhës</i>									<i>Average of period</i>
USD	103.94	100.90	108.18	105.67	113.64	120.73	123.46	129.66	USD
EURO	137.79	140.33	139.04	140.27	140.11	140.04	140.23	140.41	EURO
<i>Fundi i periudhës</i>									<i>In the end of period</i>
USD	104.00	107.54	105.85	101.86	115.23	123.35	124.96	130.63	USD
EURO	138.77	138.93	139.59	140.20	140.14	139.72	140.36	140.34	EURO

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 3

## Normat e interesit me bazë vjetore (në Lek)

Annual Interest Rates (in ALL)

Në përqindje	2010	2011	2012	2013	2014	2015			In percent
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mars Mar	
<b>Norma e depozitave</b>									Deposits rates
12-M	6.07	5.87	5.38	4.17	1.51	1.42	1.57	1.46	12-M
6-M	5.16	4.87	4.50	3.40	1.16	1.22	1.25	1.08	6-M
3-M	4.42	4.22	3.83	2.72	0.83	0.77	0.90	0.72	3-M
1-M	4.70	4.39	3.62	2.79	1.47	1.52	1.51	1.42	1-M
<b>Norma e huasë</b>									Lending rates
12-M	11.52	11.17	10.28	9.52	7.00	7.76	7.36	8.74	12-M
6-M	11.69	12.28	10.61	9.59	8.18	8.21	8.17	9.30	6-M
<b>Norma e letrave me vlerë</b>									Securities rates
Bono thesari 1/									Treasury bills 1/
3-M	5.29	5.31	5.03	3.40	3.15	3.23	3.19	3.11	3-M
6-M	6.41	6.23	5.65	3.54	3.16	3.23	3.23	3.25	6-M
12-M	7.09	6.95	6.37	3.66	3.33	3.50	3.58	3.59	12-M

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 4

## TREQUESIT FISKALË SIPAS BUXHETIT TË KONSOLIDUAR 2015

Fiscal indicators regarding consolidated budget of 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

në milionë Lekë (in million ALL)

Nr.	E M È R T I M I	Janar January	Shkurt February	Mars March	ITEMS
	<b>TOTALI TË ARDHURAVE</b>	<b>25,089</b>	<b>51,491</b>	<b>86,616</b>	TOTAL REVENUE
<b>I.</b>	<b>Të ardhura nga ndihmat</b>	<b>266</b>	<b>915</b>	<b>1,703</b>	Grants
<b>II.</b>	<b>Të ardhura tatimore</b>	<b>22,870</b>	<b>46,544</b>	<b>76,131</b>	Tax Revenue
<b>II.1</b>	<b>Nga Tatimet dhe Doganat</b>	<b>15,770</b>	<b>33,580</b>	<b>56,683</b>	From tax offices and customs
1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar	9,896	18,889	27,494	V.A. T
2	Tatimi mbi Fitimin	393	2,051	8,715	Profit Tax
3	Akcizat	1,779	4,359	7,056	Excise Tax
4	Tatimi mbi të Ardhurat Personale	1,919	3,997	6,120	Personal Income Tax
5	Taksa Nacionale dhe të tjera	1,434	3,540	6,003	National Taxes and others
6	Taksa Doganore	349	744	1,275	Customs Duties
<b>II.2</b>	<b>Të ardhura nga Pueshteti Vendor</b>	<b>540</b>	<b>1,119</b>	<b>2,168</b>	Revenues from Local Gov.
1	Taksë mbi Pasuritë (ndërtesat)	195	388	935	Property Tax
2	Taksë mbi Biznesin e vogël	5	9	16	Small Business Tax
3	Taksa Lokale	340	722	1,215	Local Taxes
<b>II.3</b>	<b>Të ardh nga fondet speciale</b>	<b>6,560</b>	<b>11,845</b>	<b>17,302</b>	Social ins. contributions
1	Sigurimi Shoqëror	4,734	8,853	12,797	Social Insurance
2	Sigurimi Shëndetësor	1,687	2,684	4,010	Health Insurance
3	Të ardhura për kompensim në vlerë të pronarëve	139	308	496	Revenues for property compensation
<b>III.</b>	<b>Të ardhura Jotatimore</b>	<b>2,557</b>	<b>4,032</b>	<b>8,982</b>	Nontax Revenue
1	Tran.Fitimi nga Banka e Shqipërisë				Profit transfer from BOA
2	Të ardhura nga Inst.Buxhetore	2,139	3,226	7,748	Income of budgetary institutions
3	Dividenti			4	Dividend
4	Tarifat shërbimeve	214	375	476	Tariffs on services
5	Të tjera	204	431	754	Other/ncd allocated
	<b>TOTAL I SHPENZIMEVE</b>	<b>22,913</b>	<b>57,255</b>	<b>91,122</b>	TOTAL EXPENDITURE
<b>I.</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>21,098</b>	<b>46,432</b>	<b>74,881</b>	Current Expenditures
<b>I.1</b>	<b>Personeli</b>	<b>5,474</b>	<b>11,301</b>	<b>17,303</b>	Personnel expenditures
1	Paga	4,764	9,767	14,873	Wages
2	Kontributi për Sigurime Shoqërore	710	1,534	2,430	Social insurance contributions
<b>I.2</b>	<b>Interesat</b>	<b>2,984</b>	<b>6,294</b>	<b>8,937</b>	Interest
1	Të Brendshme	2,606	5,354	7,475	Domestic
2	Të Huaja	378	940	1,462	Foreign
<b>I.3</b>	<b>Shpenzime Operative Mirëmbajtje</b>	<b>882</b>	<b>2,927</b>	<b>6,443</b>	Operational & Maintenance
<b>I.4</b>	<b>Subveçlonet</b>	<b>53</b>	<b>122</b>	<b>301</b>	Subsidies
<b>I.6</b>	<b>Shpenzime për fonde speciale</b>	<b>9,875</b>	<b>20,382</b>	<b>31,634</b>	Social insurance outlays
1	Sigurime Shoqërore	7,874	15,911	24,449	Social insurance
2	Sigurime Shëndetësore	2,001	4,471	6,965	Health insurance
3	Fondi i kompensimit të pronarëve			220	Expenditures for Owners Compensation
<b>I.7</b>	<b>Shpenzime për Buxhetin Vendor</b>	<b>1,127</b>	<b>3,239</b>	<b>5,684</b>	Local budget expenditure
<b>I.8</b>	<b>Shpenzime të tjera</b>	<b>703</b>	<b>2,187</b>	<b>4,599</b>	Other expenditures
1	Pagesa e Papunesisë	59	116	174	Unemployment insurance benefits
2	Ndihma Ekonomike	655	2,080	3,714	Social assistance
5	Kompensimi i ish-të përdjekurve politike	-11	-29	711	Compensation for ex-political prisoners
<b>III</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>8,830</b>	Capital expenditures
1	Financimi Brendshëm	102	925	4,568	Domestically financing
2	Financimi Huaj	1,482	2,644	4,262	Foreign financed
<b>IV.</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>231</b>	<b>7,254</b>	<b>7,411</b>	
1	Detyrimet e infrastruktures	211	4,668	4,762	
2	Detyrimet tatimore				
3	Të tjera	20	2,586	2,649	
	<b>DEFICITI</b>	<b>2,770</b>	<b>-6,764</b>	<b>-4,306</b>	CASH BALANCE
	<b>FINANCIMI DEFICITIT</b>	<b>-2,770</b>	<b>5,764</b>	<b>4,306</b>	CASH BALANCE FINANCING
	<b>Brendshëm</b>	<b>-3,825</b>	<b>-3,247</b>	<b>-4,736</b>	Domestic
	Të ardhura nga privatizimi	4	28	34	Privatization receipts
	Hua-marje e brendshme	4,868	5,441	9,153	Domestic new borrowing (net)
	Nacionale	4,877	5,452	9,072	Other
	Lokale	-9	-11	81	Foreign
	Të tjera	-8,697	-8,716	-13,923	Other
	Depozitë e Qeverisë në Bankën e Shqipërisë	-8,020	-6,497	-10,828	Government deposits into the Central Bank
	Të tjera	-679	-2,218	-3,095	Other
	Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	Deposits of Social and Health insurance
	Mjete në ruajtje	168	17	1,500	Preservation stock
	Nën-hua	58	118	118	On-Loan Principal
	Detyrim ndaj ISSH	2,785	2,525	1,982	Liabilities to SSI
	Të tjera (detyrime të përkohshme)	605	545	579	Other-Float
	<b>I huaj</b>	<b>1,055</b>	<b>9,011</b>	<b>9,042</b>	Foreign
	Hua afatgjatë(e marrë)	1,223	1,771	2,840	Long-term foreign borrowing (gross)
	Nga e cila nën-hua	406	413	845	
	Ndëshimi i gjendjes së arkës*	6	-34	-254	Chang. of stat. Account
	Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	Repayments
	Mblëstetjet Buxhetore	665	8920	8920	Budgetary Support

Burimi : Ministria e Financave

Source : Ministry of Finance

Tab - 5

**Tabela e investimeve 2015**

Table of investments 2015

*Të dhëna progresive (Progressive Data)*

*në milionë Lekë ( in million ALL)*

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	
<b>Financim i brendshëm</b>	<b>102</b>	<b>925</b>	<b>4,568</b>	<b>Domestic financing</b>
<i>Në %</i>	6.44	25.93	51.73	<i>In %</i>
<b>Financim i huaj</b>	<b>1,482</b>	<b>2,644</b>	<b>4,262</b>	<b>Foreign financing</b>
<i>Në %</i>	93.56	74.07	48.27	<i>In %</i>
<b>Totali</b>	<b>1,584</b>	<b>3,569</b>	<b>8,830</b>	<b>Total</b>
<i>Në %</i>	100	100	100	<i>In %</i>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

Tab - 6 TË ARDHURAT DOGANORE 2015 (CUSTOMS REVENUES 2015)

Të dhëna progresive (Progresive Data)

në milionë Lekë ( in million Lek)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	
Taksë doganore	349	744	1,275	Customs Duties
TVSH	5,805	12,386	20,043	V.A.T
Akcizë	1,779	4,359	7,056	Excises
Të tjera	209	412	652	Others
<b>TOTALI</b>	<b>8,142</b>	<b>17,901</b>	<b>29,026</b>	<b>Total</b>

TË ARDHURAT TATIMORE 2014 (TAX REVENUE )

TVSH	4,091	6,503	7,451	V.A.T
Akciza	0	0	0	Excises
Tatim mbi fitimin	393	2,051	8,715	Profit Tax
Tatimi mbi të ardhurat personale	1,919	3,997	6,120	Personal income tax
Taksa nacionale dhe të tjera	1,225	3,128	5,351	National taxes
<b>TOTALI</b>	<b>7,628</b>	<b>15,679</b>	<b>27,637</b>	<b>Total</b>
<b>TOTALI I PËRGJITHSHËM</b>	<b>15,770</b>	<b>33,580</b>	<b>56,663</b>	<b>OVERALL TOTAL</b>

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

## DEFICITI DHE FINANCIMI PËR 2015

The Deficit and Its Financing for 2015

Të dhëna progresive (Progressive Data)

Në milionë lekë (In million Leks)

	Janar January	Shkurt Feb	Mars Mar	
<b>TË ARDHURAT</b>	<b>25,683</b>	<b>51,491</b>	<b>86,816</b>	<b>REVENUE</b>
<b>SHPENZIMET</b>	<b>22,913</b>	<b>57,255</b>	<b>91,122</b>	<b>EXPENDITURES</b>
<b>BILANCI FISKAL</b>	<b>2,770</b>	<b>-5,764</b>	<b>-4,306</b>	<b>FISCAL BALANCE</b>
<b>FINANCIMI I BILANCIT FISKAL</b>	<b>-2,770</b>	<b>5,764</b>	<b>4,306</b>	<b>FINANCING</b>
<b>Financimi i brendshëm</b>	<b>-3,825</b>	<b>-3,247</b>	<b>-4,736</b>	<b>Domestic</b>
a. Bono Thesari Neto	793	2,101	2,116	Treasury bills
b. Obligacione	3,000	2,606	6,544	Bonds
c. <i>Ndryshimi i gjëndjes së arkës</i>	<i>-5,762</i>	<i>-5,278</i>	<i>-10,610</i>	Chang.of stat. account
Depozita e qeverisë në BSH	-8,020	-6,497	-10,828	Deposit of Government in B.O.A
Depozita e ISSH dhe ISKSH	2,258	1,219	218	Deposit of Social & Health Ins.
Mjete në ruajtje	168	17	1,500	Non-budget revenues
Të ardhura nga privatizimi	4	28	34	Privatization receipts
Të tjera detyrime (të përkohshme)	-1,139	-2,005	-2,828	Others
Huamarrje Brendshme Vendori	-9	-11	81	Local Borrowing
<b>Financimi i jashtëm</b>	<b>1,055</b>	<b>9,011</b>	<b>9,042</b>	<b>Foreing</b>
a. Hua afatgjatë	1,223	1,771	2,840	Long-term foreign borrowing (gross)
nga e cila: nën-hua	406	413	845	
b. <i>Ndryshimi I gjëndjes së arkës</i>	<i>6</i>	<i>-34</i>	<i>-254</i>	Chang. of stat. Account
Ripagesat	-839	-1,646	-2,464	Repayments
Mbeshtetje Buxhetore	665	8,920	8,920	Budgetary Support

Burimi: Ministria e Financave

Source: Ministry of Finance

**BILANCI I PAGESAVE**

Balance of payments

Në milion Euro

In millions Euro

	Viti 2013	3M_I 2014	3M_II 2014	6M_I 2014	3M_III 2014	9M_2014	3M_IV 2014	Viti 2014	3M_I 2015	
<b>Llogaria korente</b>	<b>-1,026.70</b>	<b>-271.50</b>	<b>-341.00</b>	<b>-612.50</b>	<b>-313.20</b>	<b>-925.70</b>	<b>-377.50</b>	<b>-1,303.20</b>	<b>-230.20</b>	<b>Current Account.</b>
<b>Bilanci tregtar</b>	<b>-1,729.30</b>	<b>-426.20</b>	<b>-511.40</b>	<b>-937.60</b>	<b>-560.70</b>	<b>-1,498.30</b>	<b>-638.30</b>	<b>-2,136.60</b>	<b>-468.70</b>	<b>Trade Balance.</b>
Eksporti I mallrave fob	1,731.50	212.40	264.90	477.30	228.80	706.10	219.20	925.30	169.90	Merchandise Exports. Fob
Importi I mallrave fob	-3,460.80	-638.60	-776.30	-1,414.90	-789.50	-2,204.40	-857.50	-3,061.90	-638.60	Merchandise Imports. Fob
<b>Bilanci i shërbimeve</b>	<b>8.90</b>	<b>30.00</b>	<b>38.10</b>	<b>68.10</b>	<b>97.90</b>	<b>166.00</b>	<b>102.40</b>	<b>268.40</b>	<b>103.00</b>	<b>Services Balance.</b>
Shërbimet Kredi	1,655.00	396.40	487.10	883.50	610.00	1,493.50	538.00	2,031.50	454.50	Services Credit
Shërbimet Debi	-1,646.10	366.40	449.00	815.40	512.10	1,327.50	435.60	1,763.10	351.50	Services Debt
<b>Bilanci i të ardhurave</b>	<b>-8.40</b>	<b>-20.60</b>	<b>-43.30</b>	<b>-63.90</b>	<b>-48.70</b>	<b>-112.60</b>	<b>-47.00</b>	<b>-159.60</b>	<b>-49.40</b>	<b>Balance of Incomes</b>
Të ardhurat Kredi	193.30	28.70	25.80	54.50	28.30	82.80	27.80	110.60	22.90	Income Credit
Të ardhurat Debi	-201.70	-49.30	-69.10	-118.40	-77.00	-195.40	-74.80	-270.20	-72.30	Income Debt
<b>Bilanci i transfertave</b>	<b>702.10</b>	<b>145.30</b>	<b>175.60</b>	<b>320.90</b>	<b>198.30</b>	<b>519.20</b>	<b>205.40</b>	<b>724.60</b>	<b>184.90</b>	<b>Balance of Transfers</b>
Transferta private	681.40	172.60	204.40	377.00	230.60	607.60	244.20	851.80	216.10	Private Unrequired Transfers
Transferta shtetërore	20.70	-27.30	-28.80	-56.10	-32.30	-88.40	-38.80	-127.20	-31.20	Official Unrequired Transfers
<b>Llogaria kapitale</b>	<b>47.70</b>	<b>22.50</b>	<b>22.40</b>	<b>44.90</b>	<b>20.70</b>	<b>65.60</b>	<b>21.10</b>	<b>86.70</b>	<b>26.00</b>	<b>Capital Account</b>
<b>Llogaria financiare</b>	<b>775.60</b>	<b>-161.90</b>	<b>-184.20</b>	<b>-346.10</b>	<b>-363.00</b>	<b>-709.10</b>	<b>-247.20</b>	<b>-956.30</b>	<b>-234.90</b>	<b>Financial Account</b>
Investime direkte	893.10	-168.00	-150.40	-318.40	-253.50	-571.90	-229.40	-801.30	-257.90	Direct Investment
Investime portofoli	-103.70	14.50	14.00	28.50	-12.40	16.10	104.70	120.80	-94.10	Portfolio Investment
Kapitale të tjera	-13.80	-8.40	-47.80	-56.20	-97.10	-153.30	-122.50	-275.80	117.10	Other Capital
<b>Gabime dhe harresa neto</b>	<b>315.30</b>	<b>49.90</b>	<b>104.20</b>	<b>154.10</b>	<b>86.40</b>	<b>240.50</b>	<b>70.50</b>	<b>311.00</b>	<b>25.10</b>	<b>Net errors and omissions</b>
<b>Bilanci i përgjithshëm</b>	<b>111.90</b>	<b>-37.20</b>	<b>-30.20</b>	<b>-67.40</b>	<b>156.90</b>	<b>89.50</b>	<b>-38.70</b>	<b>50.80</b>	<b>55.90</b>	<b>Overall Balance</b>
Rezervat	-104.40	-40.30	22.50	-17.80	154.00	136.20	-39.00	97.20	111.80	Reserve Assets
Përdor kred & huash nga FMN	-7.80	-3.20	52.80	49.60	-2.90	46.70	-0.30	46.40	55.90	Use of Fund Credit and Loans

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 9

**MJETET VALUTORE NETO**  
 Net Foreign Assets

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Millions of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	
Mjetet valutore neto	252,827.9	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	314,436.3	Net Foreign assets
Predendime ndaj jorezidentëve	274,628.2	276,475.7	288,142.1	294,111.3	318,940.2	332,347.1	346,806.1	349,332.6	Claims on non-residents
Minus: Detyrime ndaj jorezidentëve	21,800.3	20,817.8	21,602.1	19,913.2	26,841.9	27,427.4	35,825.9	34,896.3	Minus: Liabilities to non-residents
Mjetet e brendshme	72,244.4	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	77,731.6	Domestic Assets
Pretendimet neto ndaj qeverisë qendrore	57,937.1	57,098.0	55,145.6	44,503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	47,350.5	
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore	66,928.8	67,590.8	68,057.8	66,768.8	71,831.3	71,633.6	78,940.0	78,059.0	Net Claims on Central Government
Minus: Detyrime ndaj qeverisë qendrore	8,991.7	10,492.8	12,912.2	22,265.7	16,633.0	25,866.2	24,522.0	30,708.5	Minus: Due to Central Government
Pretendime ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	28,615.3	Claims on other depository corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera financiare	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on other financial corporations
Pretendime ndaj korporatave jofinanciare publike	-	-	-	-	-	-	-	-	Claims on public non-financial corporations
Pretendime ndaj korporatave të tjera jofinanciare	-	-	-	-	37.3	41.5	41.4	41.9	Claims on other non-financial corporations
Pretendime ndaj sektorëve të tjerë rezidentë	1,771.7	1,908.5	1,911.7	1,835.8	1,741.7	1,735.5	1,730.2	1,724.0	Claims on other resident sectors
Baza Monetare	283,453.5	289,809.0	297,721.9	308,073.7	332,899.3	331,487.2	342,191.5	338,448.3	Monetary Base
Depozita të papërfshira në paranë e gjerë	625.3	2,432.0	1,125.1	787.9	1,093.8	957.1	1,039.3	955.5	Deposits not included in broad money
Huatë	-	-	-	-	-	-	-	-	Loans
Llogari të pagueshme	797.9	901.1	1,306.1	1,309.8	14.8	26.1	8.9	29.2	Other accounts payable
Të tjera neto	-12,051.3	-12,984.4	-14,702.6	-14,102.8	-15,170.5	-15,733.5	-15,983.5	-16,017.0	Other items net
Aksione	52,246.7	59,992.0	59,947.5	45,971.3	55,786.1	63,837.9	65,515.9	68,752.0	Shares and other equity

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

**Tab - 10** **KREDIA PËR EKONOMINË**  
Credit to Economy

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Million of Lek End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	
<b>Totali i kredisë</b>	<b>483,044.8</b>	<b>541,899.9</b>	<b>554,732.2</b>	<b>547927.6</b>	<b>559,986.7</b>	<b>557,666.5</b>	<b>556,699.4</b>	<b>557,402.4</b>	<b>Total Credit</b>
<b>Kredia për qeverinë lokale</b>	-	<b>147.20</b>	<b>193.9</b>	<b>256</b>	<b>777.7</b>	<b>769.0</b>	<b>767.3</b>	<b>862.6</b>	<b>Credits to local Government</b>
Në lekë	-	147.20	193.9	256	777.7	769.0	767.3	862.6	in Lek
Në valutë	-	-	-	-	-	-	-	-	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare publike</b>	<b>9,373.9</b>	<b>18,678.5</b>	<b>23,780.7</b>	<b>24961</b>	<b>27,328.1</b>	<b>28,250.7</b>	<b>27,330.6</b>	<b>28,188.9</b>	<b>Credits to Public Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	5,022.9	8,446.2	18,474.3	20251.4	22,402.3	23,334.7	22,415.7	23,730.6	in Lek
Në valutë	4,351.0	10,232.3	5,306.4	4709.6	4,925.8	4,916.0	4,914.9	4,458.3	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat jofinanciare private</b>	<b>315,879.1</b>	<b>364,373.9</b>	<b>370,993.0</b>	<b>363541.2</b>	<b>372,166.5</b>	<b>368,219.1</b>	<b>367,939.3</b>	<b>365,598.1</b>	<b>Credits to other Non-financial Corporations</b>
Në Lekë	83,234.9	108,321.7	121,808.7	122944.7	129,429.4	126,951.2	127,328.3	128,097.4	in Lek
Në valutë	232,644.2	256,052.2	249,184.3	240596.5	242,737.1	241,267.9	240,611.0	237,500.7	in Foreign Currency
<b>Kredia për korporatat e tjera financiare</b>	<b>8,704.5</b>	<b>9,841.9</b>	<b>10,162.9</b>	<b>9578.2</b>	<b>8,270.3</b>	<b>8,237.2</b>	<b>8,041.6</b>	<b>7,950.5</b>	<b>Credits to Other Financial Corporations</b>
Në Lekë	2,957.0	3,364.2	4,031.7	4238.4	3,436.9	3,233.8	3,165.9	3,295.6	in Lek
Në valute	5,747.5	6,477.7	6,131.2	5339.8	4,833.4	5,003.4	4,875.7	4,654.9	in Foreign Currency
<b>Pretendime për sektorë të tjerë rezidentë</b>	<b>149,087.3</b>	<b>148,858.4</b>	<b>149,601.7</b>	<b>149591.2</b>	<b>151,444.1</b>	<b>152,190.5</b>	<b>152,620.6</b>	<b>154,802.3</b>	<b>Claims to other Resident Sectors</b>
Në Lekë	65,897.5	68,499.9	70,614.1	72242.5	77,396.7	77,699.1	77,729.1	79,643.7	in Lek
Në valutë	83,189.8	80,358.5	78,987.6	77348.7	74,047.4	74,491.4	74,891.5	75,158.6	in Foreign Currency

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 11

## OFERTA E PARASË

Money Supply

Mujor-Monthly

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Millions of LEK End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	
<b>Baza monetare</b>	<b>283,453.5</b>	<b>289,809.5</b>	<b>297,721.9</b>	<b>308,073.7</b>	<b>332,899.3</b>	<b>331,487.2</b>	<b>342,191.5</b>	<b>338,448.3</b>	<b>Base Money</b>
Ndryshimi vjetor në %	-0.5	5.4	2.7	3.5	8.1	8.6	12.7	11.8	Y/Y change in %
<b>Paraja jashtë korporatave depozituese</b>	<b>195,059.0</b>	<b>194,923.4</b>	<b>192,705.1</b>	<b>198,892.7</b>	<b>217,665.6</b>	<b>215,043.4</b>	<b>217,290.4</b>	<b>216,414.7</b>	<b>Currency Outside Depository</b>
Ndryshimi vjetor në %	-6.7	-0.1	-1.1	3.2	9.4	10.3	11.9	11.8	Y/Y change in %
<b>Depozita</b>	<b>785,225</b>	<b>875,230</b>	<b>930,703</b>	<b>950,088.4</b>	<b>977,420</b>	<b>972,965.8</b>	<b>974,884.4</b>	<b>974,357.7</b>	<b>Deposits</b>
Ndryshimi vjetor në %	18.5	10.5	6.3	2.1	2.9	2.4	2.6	2.6	Y/Y change in %
<b>Agregati M1</b>	<b>275,427.3</b>	<b>276,898.3</b>	<b>281,246.6</b>	<b>295,876.5</b>	<b>353,321.7</b>	<b>346,305.1</b>	<b>349,688.4</b>	<b>347,957.9</b>	<b>M1 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	-3.2	0.5	1.6	5.2	19.4	18.6	19.7	18.4	Y/Y change in %
<b>Agregati M2</b>	<b>604,517.3</b>	<b>647,007.8</b>	<b>669,577.1</b>	<b>693,172.2</b>	<b>722,356.7</b>	<b>714,347.9</b>	<b>717,983.0</b>	<b>715,949.6</b>	<b>M2 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	4.6	7.0	3.5	3.5	4.2	3.9	4.4	4.6	Y/Y change in %
<b>Agregati M3</b>	<b>980,283.9</b>	<b>1,070,153.7</b>	<b>1,123,407.8</b>	<b>1,148,980.9</b>	<b>1,195,086.3</b>	<b>1,188,009.1</b>	<b>1,192,174.7</b>	<b>1,190,772.3</b>	<b>M3 Aggregate</b>
Ndryshimi vjetor në %	12.5	9.2	5.0	2.3	4.0	3.8	4.5	4.1	Y/Y change in %
<b>Burimet e bazës monetare</b>									<b>Monetary Base sources</b>
Mjetet e huaja neto	252,827.8	255,657.9	266,540.0	274,198.1	292,098.3	304,919.7	310,980.2	314,436.3	Net foreign assets
Mjetet e brendshme neto	72,244.3	84,492.3	78,858.1	67,841.8	82,525.1	75,655.1	81,729.0	77,731.6	Domestic assets
Pretendimet ndaj qeverisë qendrore neto	57,937.1	57,098.1	55,145.6	44,503.1	55,198.3	45,767.4	54,418.0	47,350.5	Net Claims on central government
Pretendimet ndaj korporatave të tjera depozituese	12,535.6	25,485.8	21,800.8	21,502.9	25,547.8	28,110.7	25,602.4	28,615.3	Clains on other depository corporatons

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 12

**DEPOZITAT**  
 Deposits

Mujor-Monthly

Në milionë Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Millions of Leks End of Period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	
<b>Në lekë</b>	<b>409,459</b>	<b>452,085</b>	<b>476,872</b>	<b>494,279.5</b>	<b>504,691</b>				<b>In national currency</b>
<b>Depozitat e transfer + D. me likuiditet të lartë</b>	<b>80,369</b>	<b>81,975</b>	<b>88,541</b>	<b>96,983.9</b>	<b>135,656</b>	<b>131,262</b>	<b>132,398</b>	<b>131,543</b>	<b>Transferable deposits+Liquid deposits</b>
Qeveria lokale	948.1	1,157.4	1,059.7	1,305.0	2,047.5	1,391.4	1,392.3	1,466.1	Local governments
Korporata jofinanciare publike	7,134.0	7,303.4	7,168.0	6,108.2	9,799.5	8,354.8	9,270.5	7,544.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	920.6	532.5	1,789.2	937.0	1,919.8	1,274.1	856.7	1,156.4	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	22,505.0	20,681.5	24,716.6	24,244.0	38,198.6	35,599.7	34,977.6	34,321.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	48,860.8	52,300.1	53,807.9	64,389.7	83,690.6	84,641.7	85,900.9	87,054.9	Other resident sectors
<b>Depozita të tjera</b>	<b>329,090</b>	<b>370,110</b>	<b>388,331</b>	<b>397,295.6</b>	<b>369,035</b>	<b>368,043</b>	<b>368,295</b>	<b>367,992</b>	<b>Other deposits</b>
Qeveria lokale	55.1	109.6	19.4	57.1	7.8	18.8	15.8	15.9	Local governments
Korporata jofinanciare publike	3,054.3	2,608.9	1,715.4	1,257.8	1,167.9	1,083.2	585.6	590.1	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	1,773.4	1,423.5	2,224.4	2,556.5	1,730.1	1,893.8	1,762.4	2,555.6	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	8,316.8	11,292.5	10,954.1	14,523.4	11,772.0	11,497.7	13,457.9	14,509.0	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	315,890.5	354,675.1	373,417.3	378,900.8	354,357.3	353,549.3	352,473.0	350,321.1	Other resident sectors
<b>Në valutë</b>	<b>375,767</b>	<b>423,146</b>	<b>453,831</b>	<b>455,808.9</b>	<b>472,729</b>	<b>473,661</b>	<b>474,192</b>	<b>474,823</b>	<b>In foreign currency</b>
Qeveria lokale	493.0	280.5	44.5	372.6	231.3	102.8	120.5	63.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	6,201.0	5,242.2	4,011.2	4,486.2	7,099.6	7,612.5	8,010.5	7,518.9	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	8,572.0	6,022.3	6,303.3	6,673.1	4,872.9	4,428.5	4,603.1	4,641.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	57,382.9	54,418.4	46,867.5	49,382.3	55,834.3	56,871.4	56,034.9	55,310.7	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	303,117.7	357,182.4	396,604.2	394,894.7	404,691.2	404,646.1	405,422.7	407,287.7	Other resident sectors
<b>Totali</b>	<b>785,225</b>	<b>875,230</b>	<b>930,703</b>	<b>950,088.4</b>	<b>977,420</b>	<b>972,965.8</b>	<b>974,884.4</b>	<b>974,357.7</b>	<b>Total</b>
Qeveria lokale	1,496.2	1,547.5	1,123.6	1,735	2,286.6	1,513.0	1,528.6	1,545.7	Local governments
Korporata jofinanciare publike	16,389.3	15,154.5	12,894.6	11,852.2	18,067.0	17,050.5	17,866.6	15,653.2	Public non-financial corporations
Korporata të tjera financiare	11,266.0	7,978.3	10,316.9	10,166.6	8,522.8	7,596.4	7,222.2	8,353.7	Other financial corporations
Korporata të tjera jofinanciare	88,204.7	86,392.4	82,538.2	88,149.7	105,804.9	103,968.8	104,470.4	104,141.4	Other non-financial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	667,869.0	764,157.6	823,829.4	838,185.2	842,739.1	842,837.1	843,796.6	844,663.7	Other resident sectors

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania

Tab - 13

**BILANCI I PËRMBLEDHUR I BSH**  
 Consolidated BoA Balance sheet

Në milion Lekë Fundi i periudhës	2010	2011	2012	2013	2014	2015			Millions of Lek End of period
						Janar Jan	Shkurt Feb	Mar Mar	
<b>AKTIVET</b>	<b>368,032</b>	<b>384,581</b>	<b>394,834</b>	<b>398,814</b>	<b>433,878</b>	<b>450,092</b>	<b>469,195</b>	<b>473,891</b>	<b>ASSET</b>
<b>Total</b>	<b>50,480</b>	<b>48,572</b>	<b>48,288</b>	<b>40,652</b>	<b>51,880</b>	<b>61,185</b>	<b>69,219</b>	<b>69,570</b>	<b>Total</b>
Mbajtjet e SDR	8,126.9	8,226.5	8,789.7	10,508.0	19,299.7	20,589	28,614	29,255	SDR holdings
Arka në valutë	647.0	59.8	67.5	57.3	56.2	21.4	138.9	30.7	Foreign currency
Depozitat	41,705.7	40,286	39,431.1	30,086.2	32,524.0	40,574.3	40,466.6	40,284.8	Deposits
<b>Letrat me vlerë të ndryshme nga aksionet</b>	<b>280,301</b>	<b>284,210</b>	<b>294,007</b>	<b>308,387</b>	<b>320,745</b>	<b>324,262</b>	<b>329,749</b>	<b>332,379</b>	<b>Securities other than shares</b>
Jorezident	215,901.8	219,718.8	229,313.1	243,178.6	256,796.7	260,519	266,085	269,169	nonresidents
Qeveria qendrore	64,399.2	64,490.8	64,694.1	65,208.4	63,947.9	63,742.8	63,663.5	63,210.0	central government
<b>Huatë</b>	<b>14,302</b>	<b>27,388</b>	<b>23,707</b>	<b>23,333</b>	<b>27,286</b>	<b>29,843</b>	<b>27,329</b>	<b>30,335</b>	<b>Loans</b>
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	12,534.8	25,485.4	21,800.2	21,502.3	25,547.8	28,111	25,602	28,615	Other depository corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	1,767.3	1,902.8	1,906.5	1,830.9	1,738.5	1,732.0	1,726.2	1,719.3	Other resident sectors
<b>Derivatet financiare</b>	<b>81.4</b>	<b>35.3</b>	<b>14.2</b>	<b>31.5</b>	<b>17.4</b>	<b>20.8</b>	<b>35.1</b>	<b>34.5</b>	<b>Financial derivatives</b>
<b>Llogari të arketueshme</b>	<b>10,748.3</b>	<b>11,295.9</b>	<b>14,129.2</b>	<b>11,994.1</b>	<b>18,197.8</b>	<b>18,584.3</b>	<b>26,811.9</b>	<b>25,478.7</b>	<b>Receivable accounts</b>
<b>Mjetet jofinanciare</b>	<b>12,119.1</b>	<b>13,080.0</b>	<b>14,688.0</b>	<b>14,416.4</b>	<b>15,752.1</b>	<b>16,198.1</b>	<b>16,051.5</b>	<b>16,094.2</b>	<b>Nonfinancial assets</b>
<b>DETYRIMET</b>	<b>368,032</b>	<b>384,581</b>	<b>394,834</b>	<b>398,814</b>	<b>433,878</b>	<b>449,770</b>	<b>469,195</b>	<b>473,891</b>	<b>LIABILITIES</b>
<b>Total</b>	<b>202,644</b>	<b>203,009</b>	<b>201,086</b>	<b>208,042</b>	<b>226,588</b>	<b>224,140</b>	<b>226,296</b>	<b>226,418</b>	<b>Total</b>
Para në qarkullim	202,386.7	202,906.6	200,898.7	207,792.7	226,434.1	224,010	226,134	225,390	Currency in Circulation
Depozitat e përfshira në paranë e gjerë	256.8	102.8	187.3	249.7	154.2	130.5	161.4	1,028.5	Deposits included in broad money
<b>Depozita të papërfshira në paranë e gjerë</b>	<b>98,842</b>	<b>108,017</b>	<b>120,691</b>	<b>132,765</b>	<b>140,569</b>	<b>150,651</b>	<b>165,262</b>	<b>166,575</b>	<b>Deposits excluded from broad money</b>
Jorezident	8,440.3	8,318.7	10,042.9	9,706.5	16,564.1	16,539	23,890	23,874	Nonresidents
Qeveria qendrore	8,966.2	10,465.6	12,887.1	22,239.2	16,600.5	25,807	24,437	29,715	Central government
Korporata të tjera depozituese	80,810.0	88,570.2	97,054.7	100,031.3	106,310.9	107,347	115,896	112,030	Other depository corporations
Korporata të tjera jofinanciare	14.9	20.5	37.2	62.5	85.0	86	95	94	Other nonfinancial corporations
Sektorë të tjerë rezidentë	610.4	641.5	669.2	725.4	1,008.8	871	945	861	Other resident sectors
<b>Huatë</b>	<b>5,921</b>	<b>4,852</b>	<b>3,871</b>	<b>2,919</b>	<b>2,294</b>	<b>2,294</b>	<b>2,153</b>	<b>2,103</b>	-
Jorezidentët	5,920.6	4,852.0	3,870.7	2,919.3	2,294.2	2,294	2,153	2,103	Nonresidents
Qeveria qendrore	-	-	-	-	-	-	-	-	Central Government
Korporata të tjera depozituese	-	-	-	-	-	-	-	-	Other depository corporations
<b>Llogari të pagueshme</b>	<b>936.4</b>	<b>1,064.3</b>	<b>1,680.5</b>	<b>1,828.3</b>	<b>886.8</b>	<b>1,096</b>	<b>1,760</b>	<b>1,649</b>	<b>Other accounts payable</b>
<b>Alokimi i SDR</b>	<b>7,439.5</b>	<b>7,647.1</b>	<b>7,557.9</b>	<b>7,287.5</b>	<b>7,753.2</b>	<b>8,074</b>	<b>8,209</b>	<b>8,395</b>	<b>SDR allocation</b>
<b>Aksione dhe instrumenta të tjerë</b>	<b>52,249.7</b>	<b>59,992</b>	<b>59,947.5</b>	<b>45,971.3</b>	<b>55,786.1</b>	<b>63,516</b>	<b>65,516</b>	<b>68,752</b>	<b>Shares and other equity</b>

Burimi : Banka e Shqipërisë

Source : Bank of Albania